

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-66/2014**

**Prishtinë,  
18 November 2015**

Në çështjen juridike të:

**S.T.J.**  
Rruga Banjicka, 48  
35000, Jagodinë

***Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese***

kundër

**F.R.R.**  
Gjilan

***Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA31345), të datës 18 prill 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 18 Nëntor 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S.T.J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013, të datës 18 prill 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA31345.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013, i datës 18 prill 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA31345.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 11 maj 2007, pala ankuese S.T.J. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës së saj pronësore mbi ngastrën e tokës nr. 1766/3, që ndodhet në Gjilan, me sipërfaqe prej 0.43.62 (në tekstin e mëtejme: toka).
2. S.T.J. kishte theksuar se toka është duke u shfrytëzuar ilegalisht nga F.R., i cili e ka bartur ilegalisht ngastrën e tokës në emrin e tij. Për më tepër, ajo ka theksuar se kishte humbur mundësinë për të ushtruar të drejtën e saj pronësore për shkak të rrethanave që kanë rezultuar nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në vitet 1998/99.
3. Kërkesa e paraqitur nga S.T.J. është hedhur poshtë me vendimin KPCC/D/A/196/2013, të datës 18 prill 2013, (në tekstin e mëtejme: vendimi i KKPK-së) mbi argumentin se çështja e njëjtë ndërmjet palëve të njëjta është vendosur përfundimisht më herët në vitin 2003 me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan. Çështja rrjedhimisht është bërë *res judicata* në mes të palëve.
4. Më 22 tetor 2013, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë, F.R.R. . Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 11 dhjetor 2013.

5. Më 23 dhjetor 2013, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.
6. Më herët, e drejta pronësore dhe ri-posedimi i ngastrës së theksuar të tokës kishte qenë subjekt gjykimi në Gjykatën Komunale në Gjiilan. Me aktgjykimin e lëshuar në lëndën C nr. 383/2002 më 2 dhjetor 2003, Gjykata Komunale ka miratuar kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë kundër palës ankuese dhe kishte vërtetuar se pala përgjegjëse në ankesë është pronar i ngastrës së tokës nr. 1766, të regjistruar në Fletën Poseduese nr. 1676. Gjykata Komunale gjithashtu ka urdhëruar regjistrimin e pronës së paluajtshme në regjistrat kadastral në emër të palës përgjegjëse në ankesë.

### **Pretendimet e palëve**

7. Pala ankuese S.T.J. kërkon që Gjykata Supreme të kthej pjesën e saj të pronës. Pala ankuese ka shtuar se nga ngastra e tokës nr. 1766/3 në sipërfaqe prej 0.43.62 m<sup>2</sup> pjesa e saj e ngastrës është në sipërfaqe prej 0.15.00 m<sup>2</sup> dhe ndodhet në pjesën e sipërme të rrugës. Sipas palës ankuese pjesa tjetër prej 0.28.95 m<sup>2</sup> i takon palës përgjegjëse në ankesë, i cili e ka përvetësuar pjesën e saj të ngastrës së tokës. Duke iu referuar argumentit të ngritur në Vendim nga KKPK se ajo nuk ka ndërmarrë asnjë veprim kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, S.T.J. ka theksuar se ajo kishte mësuar për Aktgjykimin në vitin 2005 dhe menjëherë pas kësaj ajo e kishte informuar KKPK-në për këtë fakt ku dhe kishte kërkuar kthimin e pronës.
8. Ankesa i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 28 prill 2014. F.R. nuk kishte paraqitur përgjigje në ankesë.

### **Arsyetimi ligjor**

9. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave nga dosja e lëndës, vendimit të kundërshtuar dhe pretendimeve të palës ankuese, gjeti se ankesa është e pabazuar.

11. Sipas parimit *res judicata* lënda nuk shqyrtohet nga gjykata kur çështja e njëjtë, me të njëjtat palë pjesëmarrëse në procedurë, tashmë është gjykuar nga ndonjë gjykatë tjetër. Kjo është situata në rastin aktual, kërkesa e njëjtë është paraqitur dhe është vendosur nga Gjykata Komunale në Gjilan dhe palët pjesëmarrëse kanë qenë të njëjta në të dyja procedurat. Gjithashtu, faktet dhe baza ligjore ishin të njëjta në të dyja rastet.

12. KKPK me të drejtë ka hedhur poshtë kërkesën e S.T.J. mbi bazën se çështja përbënë *res judicata* në mes të palëve të njëjta. Çështja e njëjtë tashmë është gjykuar me Aktgjykimin e plotfuqishëm, të datës 2 dhjetor 2003, para se kërkesa në fjalë të paraqitej. Me aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata kishte miratuar kërkesën dhe kishte vërtetuar se pala përgjegjëse në ankesë në rastin aktual është pronar i pronës tokësore që ceket në kërkesën e S.T.J. . Rrjedhimisht, pala ankuese nuk mund të lejohet që kërkesa e saj e njëjtë të dëgjohet përsëri lidhur me çështjen e njëjtë në mes të palëve të njëjta.

13. Megjithatë është me rëndësi të ceket se nga këndvështrimi i Gjykatës Supreme pretendimet e palës ankuese lidhur me një pjesë të ngastrës në sipërfaqe prej 0.15.00 m<sup>2</sup> që ndodhet në pjesën e sipërme të rrugës, nuk janë të bazuara dhe nuk mbështeten me asnjë dokumentacion. Siç duket nga Aktgjykimi i përmendur më lartë, si dhe nga Vendimi i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i Komunës së Gjilanit i datës 5 janar 2004, e tërë ngastra e cila ka qenë më herët e regjistruar me numrin 1766/3 ishte e regjistruar në emër të palës përgjegjëse në ankesë. Për këtë arsye Gjykata Supreme konsideron se pretendimet e palës ankuese nuk kanë mundur të konsiderohen si të bazuara dhe nuk kanë mundësuar ndryshimin e vendimit të KKPK-së.

14. Si përfundim, Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KKPK-së ka qenë i drejtë për sa i përket hedhjes poshtë të kërkesës brenda kufijve të juridiksionit dhe kompetencës së KKPK-së në përputhje me nenin 11.4.c të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe duhet të mbështetet.

15. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 166, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

16. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**